

# KULTURA 2023



Nr.23

BULETINI MUJOR / NËNTOR

kultura.gov.al



## “FOLK FEST” MBLODHI GJITHË SHQIPTARËT NË DITËN E FLAMURIT

“Folk Fest”, parada e këngëve, valleve dhe kostumeve popullore nisi rrugëtimin në Ditën e Flamurit. Rreth 500 artistë dhe bartës të trashëgimisë kulturore jomateriale, grupe nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, arbëreshët e Italisë u bënë bashkë në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit në datën 28 Nëntor. Qindra qytetarë dhe përfaqësues të lartë të shtetit nga Shqipëria e Kosova ndoqën dhe shijuan përgjatë tri orëve këngë e valle nga Tropoja, Fieri, Labëria, Korça, Dropulli, Lunxhëria, Rrajca, Lezha, Mirdita, Mati, Skrapari etj., përgjeshur mes performan-

**RETH 500 ARTISTË DHE BARTËS TË TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE, GRUPE NGA SHQIPËRIA, KOSOVA, MAQEDONIA E VERIUT, ARBËRESHËT E ITALISË U BËNË BASHKË NË SKENËN E TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS DHE BALETIT NË DATËN 28 NËNTOR.**

cave më të mira të Festivalit Mbarëkombëtar Folklorik të Gjirokastrës 2023, i cili u rikthye për publikun pas 8 viteve mungese dhe shënoi një nga edicionet më të suksesshme që ka njohur historia e këtij festivali. Ky koncert shënoi kulmin e Javës Kulturore Kombëtare, mbushur me aktivitete të shumëllojshme: koncerte, ekspozita, promovime librash, shfaqje teatrore, organizuar si një bashkëpunim mes Shqipërisë dhe Kosovës. Po ashtu, fillimin e një rrugëtimi që do të vijojë përgjatë vitit 2024 në të gjithë Shqipërinë.



## “CALL FOR ACTION”, THIRRJA E UNSCO-S PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Ministria e Kulturës, znj. Elva Margariti mori pjesë në konferencën “Trashëgimia kulturore në shek. XXI”, në Napoli, për t’iu bashkuar nismës së UNESCO-s dhe qeverisë italiane “Call for Action”, për të ritur përgjegjësinë përballë sfidave me të cilat po na përball ky shekull, që nga ndryshimet klimatike, te kërkesat e reja të një turizmi kulturor gjithnjë në rritje. “Call for Action” është një thirrje për të respektuar konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, por mbi të gjitha për t’ia vënë ato në shërbim njeriut, brezave të ardhshëm, që duhet ta gëzojnë dhe përcjellin. Në fjalën e saj ministria Margariti vuri theksin në rjetësimin e trashëgimisë kulturore dhe vënien në shërbim të komuniteteve si një e mirë publike.



## GËRMIMET NË HIMARË NXJERRIN NË DITË OBJEKTE TË KULTURËS ILIRE

U përmbyll me rezultate mbresëlënëse ekspedita e gërmimeve arkeologjike pranë varrezës tumulare në Himarë. Përgjatë gërmimeve u zbuluan dhe dokumentua tuma e tretë, që paraqet elemente unike të arkitekturës së ndërtimit të kodërvarreve, krahasuar me kodërvarret e tjera të njohura dhe studiuar deri më tani në vendin tonë. Gjatë gërmimeve u zbuluan edhe disa objekte arkeologjike, mes të cilave një enë balte dhe një majë heshte e periudhës së hekurit të hershëm (shek. XI-X p.Kr). Tumat prehistorike të Himarës konsiderohen si monumentet më befasese të periudhës së bronzit dhe hekurit në bregdetin jonian. Kultura e dokumentuar në to është e njëjtë me atë të pjesës tjetër të Ilirisë.

## SHTËPIA E ARBËRESHËVE DHE PAVIJONI I GJUHËS, PREMTIMET E SAMITIT III TË DIASPORËS

U zhvillua në Tiranë Dita Arbëreshe dhe Samiti III i Diasporës. Paneli i kulturës gjatë Ditës Arbëreshe iu dedikua rrugëve kulturore që lidhin dy brigjet e Adriatikut: “Moti i Madh” dhe “Itinerari deradian”, të cilat u prezantuan nga profesorët dhe studiuesit e nderuar Francesco Altamari, Matteo Mandala, Shaban Sinani, Blerina Suta, Meri Kumba, Suzanne Ogge, kryetari i bashkisë San Demetrio Corone Ernesto Madeo dhe arkitekti Gjon Radovani. Kjo ditë u mbyll me prezantimin e projektit të ndërtimit të Shtëpisë së Arbëreshëve, nga kryeministri Edi Rama. Gjatë Samitit të Diasporës, Ministria e Kulturës i dedikoi një panel gjuhës shqipe si trashëgimi dhe mbijetesë, se si ka mbajtur gjallë ajo diasporat e ç’mund të bëhet për ta mbrojtur dhe përcjellë te brezat e rinj. Pedagogë në universitete ndërkombëtare si Matteo Mandala, Vito Matranga, Gëzim Gurga, Entela Tabaku, Loreta Schillock, nën moderimin e pedagoges dhe studiuses Linda Mëniku sollën eksperiencat e tyre nga Italia, Suedia e Gjermania. Ndërsa u prezantua edhe projekti i pavijonit dedikuar gjuhës shqipe në Muzeun Historik Kombëtar.



## BUXHETI 2024, KULTURA DO TË KETË 30% MË SHUMË INVESTIME

Kuvendi i Shqipërisë miratoi buxhetin për vitin 2024. Buxheti i vitit 2024 për kulturën do të jetë 14% më i lartë krahasuar me vitin 2023. Rritja e buxhetit është më e madhe në zërin e pagave me 29% më shumë krahasuar me 2023, ndërsa investimet 30% më shumë. Gjatë vitit 2024 Ministria e Kulturës do të çojë përpara nismat madhore të qeverisë shqiptare dhe do të vijojë me projekte të reja tepër ambicioze, që nga restaurimi dhe rikonceptimi i Muzeut Historik Kombëtar, te Muzeu “Besa”, gërmimi i amfiteatrit të Durrësit dhe rehabilitimi i zonës arkeologjike përreth, restaurimi i Teatrit “Aleksandër Moisiu”, rehabilitimi i objekteve dhe ambienteve të Burgut të Spaçit e shumë të tjera. Pa lënë mënjanë edhe mbështetjen e skenës së pavarur përmes mbështetjes financiare.

**14% MË I LARTË DO TË JETË BUXHETI I VITIT 2024 PËR KULTURËN KRAHASUAR ME VITIN 2023. RITJJA E BUXHETIT ËSHTË MË E MADHE NË ZËRIN E PAGAVE ME 29% MË SHUMË SE NJË VIT MË PARË, NDËRSA INVESTIMET 30% MË SHUMË.**

## KONSULTIMI PUBLIK, MINISTRIA E KULTURËS DISKUTON NDRYSHIMET NË LIGJIN “PËR LIBRIN”

Ministria e Kulturës zhvilloi serinë e konsultimeve publike me palët e interesit mbi disa ndryshime të propozuara në Ligjin për Librin në Republikën e Shqipërisë. Rishikimi i Ligjit për Librin lindi si rezultat i disa kërkesave urgjente: Për të rregulluar me ligj funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, duke specifikuar të drejtat dhe detyrimet e këtij institucioni; Për t’iu përgjigjur një kërkesë dhe një nevojë të kahershme të Bibliotekës Kombëtare për të mirëmenazhuar numrin e kopjeve të detyrueshme të titujve të rinj që dorëzohen në të. Përmes këtij propozimi, nga 5 kopje që entet botuese dorëzojnë, 2 shpërndahen në biblioteka publike. Për të siguruar me ligj pasurimin e bibliotekave publike, duke nënvizuar që fondet e përvitshme dedikuar blerjes së titujve të rinj në buxhetet e institucioneve të pushtetit vendor të mos tjetërsohen, por të përdoren vetëm për këtë qëllim. Për të përmbytur kërkesat e një kategorie lexuesish me aftësi ndryshe, çka përputhet dhe me qasjen me standartet e Bashkimit Europian.

